



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

KOMENTE NGA ANËTARË E BASHKËPUNËTORË TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

2024

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

KËSHILLI I INVESTIMEVE është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga Sekretariati i përbërë nga një grup i pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtores e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al



Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

[f Albania Investment Council](#) [ALInvestCouncil](#) [in Albania Investment Council](#)



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).



KOMENTE NGA ANËTARË E BASHKËPUNËTORË TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE 2024

Materiali është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Xaira Shurdha, Eksperte e Ndërlidhjes dhe Monitorimit nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) me mbështetjen e z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor e Rregullator dhe znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomie. Materiali është redaktuar nga znj. Elisa Lula, Specialiste e komunikimit pranë Sekretariatit, duke ofruar mbështetje edhe në përgatitjen e dizajnit.


Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në komentet e bashkëpunëtorëve të Këshillit të Investimeve të kontaktuar përmes një pyetësori online, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

PËRMBAJTJA

01	Mesazhe Kryesore	F. 06-07
02	Konteksti	F. 08-09
03	Formati dhe Organizimi i KI si një Platformë Efektive Dialogu	F. 10-16
04	Tre Pikat më të Forta të KI	F. 17
05	Përfshirja e Komunitetit të Biznesit dhe e Institucioneve Publike	F. 18-19
06	Vizibiliteti i KI	F. 20-21
07	Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve	F. 22-23
08	Eksperienca Personale dhe Profesionale me KI	F. 24-25
09	Qëndrueshmëria e Platformës së KI	F. 26
10	Vijueshmëria e Bashkëpunimit me KI/Anëtarët e KI	F. 27
11	Shtojca 1. – Pyetësori drejtuar anëtarëve e bashkëpunëtorëve të KI	F. 28

01

Mesazhe Kryesore



Këshilli i Investimeve është krijuar për të përmirësuar klimën e biznesit dhe qeverisjen e mirë në Shqipëri. Platforma synon të ofrojë një kanal për dialog të hapur dhe konstruktiv mes qeverisë dhe sektorit privat, duke përfshirë një gamë të gjerë aktorësh si biznese/shoqata biznesi, institucione publike, organizata ndërkombëtare dhe shoqëri civile. Për realizimin e misionit të Këshillit të Investimeve, është thelbësore jo vetëm angazhimi i anëtarëve të tij, por edhe bashkëpunimi me individë dhe organizata të ndryshme, si bizneset nga sektorë të ndryshëm, ekspertë ligjorë, financiarë, të teknologjisë së informacionit dhe sektorëve specifikë, institucione publike, universitete, institucione kërkimore, shoqëri civile dhe media.

Përmes vlerësimit të këtij viti nga anëtarët e bashkëpunëtorët, evidentojmë disa mesazhe kryesore, sa i përket arritjeve pozitive:

- » **Anëtarët e KI përgjithësisht shprehen optimistë për ndikimin e platformës në përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri.** 88% e të anketuarve besojnë se KI ka ndihmuar në nxitjen e institucioneve publike për të reaguar ndaj kërkesave dhe shqetësimeve të sektorit privat.
- » **“Puna aktive e Sekretariatit, analizat dhe puna studimore e përcjellë përmes materialeve analitike” konsiderohet për disa vite rresht si pika më e fortë e KI.** Gjithashtu përmirësimi i transparencës përmes materialeve të publikuara, është cilësuar si një nga sukseset kryesore me përmirësim të dukshëm nga vitet e mëparshme.

- » **Mbështetja e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)** është cilësuar si një faktor kyç që rrit besimin dhe paanshmërinë e platformës.
- » **Materialet analitike të prezantuara në mbledhjet e KI janë vlerësuar nga 84% e të anketuarve për qartësinë dhe saktësinë e tyre.** Materialet ndihmojnë në strukturimin e debatit dhe ofrojnë bazë të fortë për diskutimet ndërmjet sektorit publik dhe privat.
- » **Shumica e anëtarëve (96%) shprehen se KI duhet të vazhdojë si një platformë afatgjatë dialogu,** duke e konsideruar atë një mjet të rëndësishëm për bizneset në Shqipëri. Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të platformës në të ardhmen, nga anëtarët evidentohej një barazi opinionesh mes vijimit me të njëjtin format dhe formatimit në institucion më vete nga respektivisht 44% e anëtarëve për secilin opcion.
- » **72% e të anketuarve konsiderojnë Informimin dhe Avokimin Publik** si përfitimin më të madh nga angazhimi me Këshillin e Investimeve si edhe advokimin e rekomandimeve në aktivitete të organizuara nga partnerë të tjerë.

Ndërsa mesazhet kryesore në drejtim të nevojës për përmirësim, konsistojnë si më poshtë:

- » Ndonëse vlerësohet gjithëpërfshirja, përsëri **evidentohej rritje e interesit për pjesëmarrje dhe rekomandohet rritja e numrit të pjesëmarrjes** dhe diversifikimi i përfaqësimit si nga ana sektoriale ashtu edhe akademika dhe shoqëria civile.
- » Një nga komentet kyçe është që institucionet publike duhet të angazhohen më shumë dhe të ofrojnë përgjigje më të qarta dhe të detajuara mbi rekomandimet e KI. **Pjesëmarrësit kërkojnë një përfaqësim më profesional nga ana e institucioneve publike në mbledhjet e KI, si dhe një angazhim më të madh në ndjekjen e rekomandimeve të dhëna.**
- » **Kërkesë për fokusim më të madh në diskutime:** Disa anëtarë kanë sugjeruar që diskutimet në mbledhjet e KI të jenë më të përqendruara dhe më të shkurtra. Ata theksojnë rëndësinë e fokusimit në temat më të rëndësishme dhe diskutimet duhet të rezultojnë në hapa konkrete që do të merren pas mbledhjeve.
- » **Rekomandimet e miratuara nga KI janë vlerësuar maksimalisht për cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre nga 80% e të anketuarve,** duke reflektuar nevojat dhe sfidat e sektorit privat. Megjithatë, disa anëtarë kanë sugjeruar se duhet të ketë përmirësime në koherencën dhe llogaridhënien e institucioneve për përshpejtimin e zbatimit e rekomandimeve.
- » Hapësirë për përmirësim konsiderohet edhe **mbi mundësimin e konsultimeve të akteve ligjore, përfshirjen e anëtarëve në analiza dhe nivelin e diskutimit të anëtarëve.**

02 Konteksti

Në raportin e vitit 2022, u evidentua interesi në rritje i disa aktorëve të biznesit për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në platformën e Këshillit të Investimeve. Në vijim të këtij interesi dhe kërkesave specifike, në Dhjetor 2023 u ndërmor ndryshimi i VKM Nr. 294, date 8.4.2015 “Për ngritjen e Këshillit të Investimeve”¹ ku numri i anëtarëve u rrit me +4 të rinj nga radhët e biznesit, duke e çuar totalin e anëtarëve në 20 gjithsej.

Aktualisht, përfaqësues të institucioneve publike janë 4 anëtarë, partnerët për zhvillim janë 3 anëtarë, dhe komuniteti i biznesit përfaqësohet nga 3 dhoma tregtie e industrie, 8 shoqata biznesi dhe 2 kompani private me mandat të posaçëm. Këto përfaqësues çdo vit kontribuojnë në (a) prioritizimin e çështjeve kryesore dhe hartimin e agjendës së KI-së, (b) suportojnë me konsultimet mbi tema të përzgjedhura, (c) ndihmojnë më shpërndarjen e plotësimit të anketave vjetore si dhe (d) sugjerojnë rekomandime konkrete mbi problematika të klimës së investimeve.


Që nga viti 2016, Sekretariati i KI vlerëson periodikisht cilësinë e punës së kësaj platforme duke u bazuar dhe përcjellë me transparencë² komentet dhe sugjerimet e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Procesi i mbledhjes së komenteve ka ndryshuar në vitet e fundit. KI ka kryer një anketim të detajuar dhe anonim, duke lejuar anëtarët dhe bashkëpunëtorët të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe anonime për të mundësuar një vlerësim sa më të paanshëm. Kjo metodologji ka bërë që vlerësimet të jenë më të sakta dhe më të detajuara, duke ofruar mundësi për një analizë më të thellë të punës së Këshillit.

¹ Ndryshuar me Vendimin e KM nr. 335, datë 22.5.2019, nr. 746, datë 20.11.2019, nr. 754 datë 20.12.2023

² Raporte të mëparshme, gjenden në linkun <https://www.investment.com.al/sq/reagime-nga-anetaret-dhe-part-neret-e-ic/>

Në përputhje me këtë metodologji dhe standardin e punës së KI, gjatë periudhës shtator - tetor 2024, u kontaktuan 65 anëtarë e bashkëpunëtorë të KI nga të cilët, 25 përcollën pikëpamjet e tyre përmes plotësimit të pyetësorit online.

Figura 1. Përbërja e të anketuarve




Duke vlerësuar maksimalisht angazhimin e të intervistuarve për të ofruar pikëpamjet e tyre mbi pyetjet e detajuara, çmojmë veçanërisht disa **sugjerime të dhëna në drejtim të përmirësimit të punës** së KI, që lidhen edhe me vetë anëtarësinë:

- » Referuar anëtarësisë, sugjerohet pjesëmarrja e disa subjekteve si Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Pasurive të Paluajtshme (NAREA), Unioni i Sipërmarrësve të Rinj të Shqipërisë (YPN), Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (AITA).
- » Mbi përfaqësimin e dhomave të tregtisë, sugjerohet që të jetë e mundur që përfaqësimi në KI i tyre të mos ishte i mundur jo vetëm për Kryetarët, por edhe për bizneset anëtare të tyre që lidhen me tematikën e trajtuar në KI në bazë rotacioni të vazhdueshëm.
- » Me rëndësi cilësohet edhe vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve të KI në lidhje me ndryshimet në politikat, aktet ligjore apo kuadrin rregullator, mbi biznesin.

Në seksionet e mëposhtme sjellim në mënyrë të detajuar pikëpamjet dhe sugjerimet e bashkëpunëtorëve sipas komponentëve kryesorë të trajtuar.

03

Formati dhe Organizimi i KI si një Platformë Efektive Dialogu




Nën këtë komponent, të intervistuarit shprehën opinionin e tyre mbi (1) Anëtarësinë e KI, (2) Agjendën/Tematikat e trajtuara nga KI, (3) Metodologjinë e punës, (4) Cilësinë e materialeve analitike, (5) Rekomandimet, (6) Avokimi i çështjeve të trajtuara/Ndjekja e diskutimeve, dhe (7) Procesi i raportimit tek Anëtarët e KI.

Metoda e vlerësimit të pikëve të mësipërme u bë përmes përzgjedhjes së pesë opsioneve: “Duhet përmirësuar”, “Mirë”, “Kënaqshëm”, “Shumë mirë”, “Shkëlqyeshëm”, dhe vetëm në rastin e përzgjedhjes së opsionit “Duhet Përmirësuar”, të intervistuarit kishin mundësinë të shprehnin komente specifike. Për lehtësi shprehje grafike, indikatorët në grafikët e mëposhtëm janë grupuar në “Mirë” (përfshin “Duhet përmirësuar”, “Kënaqshëm”), dhe “Shumë mirë” (përfshin “Shkëlqyeshëm”).

3.1 Anëtarësia e KI

Ky komponent u vlerësua bazuar në indikatorët (1) Numri i anëtarëve, (2) Përbërja e anëtarësisë, (3) Balancimi publik - privat, ku shumica e të anketuarve, në 60-68% dhanë vlerësimin “Shumë mirë” për të tre këto indikatorë.

Figura 2. Vlerësimi i Anëtarësisë së KI



Më specifikisht, komentet e dhëna nga të anketuarit që kanë vlerësuar se ka nevojë për përmirësim në këtë drejtim, lidhen me sugjerimet mbi zgjerimin e anëtarësisë dhe pjesëmarrjes si të ftuar në mbledhje. Kështu, është propozuar që si anëtarë të mundshëm mund të konsideroheshin:


- » **Aktorë të trinit Ndërtim-Pasuri e Paluajtshme-Turizëm**, që reflektojnë rreth 1/3 e PBB, dhe që konsiderohet e nën përfaqësuar në KI.
- » **Eksptertë të zhvillimit ekonomik**: Specialistë që kanë përvojë në strategjitë e zhvillimit ekonomik dhe analizat e tregut.
- » **Akademikë**: Profesorë ose hulumtues që merren me studime mbi ekonominë dhe investimet, për të sjellë një qasje teorike.
- » **Eksptertë të politikave publike**: Njerëz që kuptojnë politikën dhe mund të ndihmojnë në formulimin e politikave të favorshme për investime.

Gjithashtu, të anketuarit kanë komentuar që “anëtarësia e KI duhet të jetë më dinamike pasi përgjatë viteve një pjesë e saj është përbërë nga të njëjtit aktorë dhe kjo perceptohet si një aspekt që mund të ndikojë në produktivitetin dhe ndikimin e platformës”.

3.2 Tematikat e trajtuara në Këshillin e Investimeve

Mbi 60% e të anketuarve, kanë vlerësuar me “shumë mirë”, këtë komponent duke iu referuar tre indikatorëve: (1) Përzgjedhja e Tematikave, (2) Procesi i votimit të temave, (3) Miratimi përfundimtar i agjendës.

Figura 3. Tematikat e trajtuara në KI




Të anketuarit që gjykojnë se ka nevojë për përmirësim, komentojnë se *tematikat mund të jenë më të fokusuara në disa raste*.

3.3 Frekuenca e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve

- » Nga 60% e të anketuarve, vlerësohet frekuenca aktuale e mbledhjeve të KI si “Shumë e mirë” dhe 24% e tyre si “Kënaqshëm”. Nuk ka pasur komente specifike nga 16% që e gjykojnë frekuencën si “Mirë”/“Duhet përmirësuar”.

Figura 4. Frekuenca e mbledhjeve të KI




3.4 Metodologjia e punës së Këshillit të Investimeve

Metodologjia e punës, u vlerësua përmes disa kategorive (1) Qasja nga poshtë-lart, (2) Konsultime aktesh ligjore, ligje e projektligje, (3) Përfshirja e anëtarëve, (4) Anketimet periodike, (5) Koha e shkëmbimit të njoftimeve, (6) Diskutimet teknike në fokus grupe, (7) Diskutimet nga anëtarët e të ftuarit në mbledhje, (8) Aspekti operacional i organizimit të mbledhjeve.

Mbi 56% e të anketuarve i konsiderojnë “Shumë Mirë” të gjithë indikatorët. “Aspekti operacional i organizimit të mbledhjeve”, është vlerësuar me “Shumë mirë” nga 76% e të anketuarve, ndërkohë që konsultimet e akteve ligjore, përfshirja e anëtarëve në analiza dhe niveli i diskutimit të anëtarëve zënë një % pak më të ulët kënaqësie rreth 60-64%.


Figura 5. Metodologjia e punës së KI



3.5 Cilësia e materialeve analitike të paraqitura në Këshillin e Investimeve

Të tre kategoritë e përzgjedhura për vlerësimin e këtij komponenti, u vlerësuan kryesisht me “Shumë Mirë” dhe “Shkëlqyeshëm” (mbi 76%), ndërkohë që “Saktësia e të dhënave” ri-konfirmohet si indikator më i vlerësuar, sikurse shihet në grafikun më poshtë.

Figura 6. Cilësia e materialeve analitike




3.6 Prezantimi i Gjetjeve dhe Rekomandimeve në mbledhjet e KI

Në çdo mbledhje të KI, përfaqësuesi i Sekretariatit të KI prezanton shkurtimisht (rreth 10 minuta) gjetjet kryesore dhe rekomandimet e evidentuara gjatë punës analitike dhe takimeve konsultuese me sektorin privat. Materiali i plotë analitik u dërgohet anëtarëve rreth 1 javë para mbledhjes së KI. Ndërsa një prezantim i shkurtër u përcillet anëtarëve në fillim të mbledhjes, duke u mundësuar bazën analitike me pikat kryesore që strukturojnë debatin mes përfaqësuesve të bizneseve dhe atyre të qeverisë.

96% e anëtarëve janë në favor të prezantimit paraprak dhe referuar pyetjes nëse përmbledhësja duhet ndryshuar, 48% e të anketuarve mendojnë se duhet diskutuar më gjatë dhe 16% e tyre mendojnë se duhet të jetë më e shkurtër. Përgjigjet e të anketuarve, mund të lidhen edhe me faktin se deri në çfarë shkalle i kanë lexuar materialet paraprakisht të ftuarit/pjesëmarrësit në mbledhje.

Figura 7. Prezantimi i materialeve analitike




3.7 Rekomandimet e propozuara dhe miratuara në mbledhjet e KI

Mbi 76% e të anketuarve vlerësojnë “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm” të gjitha kategoritë e konsideruara për vlerësimin e këtij komponenti (1) Cilësia, (2) Përshtatshmëria, (3) Koherenca, (4) Llogaridhënia e Publikime, ku Relevanca e rekomandimeve merr vlerësimin maksimal.

Rreth 24% sugjerojnë më shumë vëmendje në drejtim të përmirësimit të koherencës të rekomandimeve.

Figura 8. Rekomandimet e propozuara dhe miratuara në mbledhjet e KI




3.8 Avokimi i çështjeve të trajtuara në KI

Kjo kategori përmban dy aspekte “Avokimin mbi nxitjen e aktorëve me influencë drejt përmbushjes së rekomandimeve” dhe “Avokimit në takime të organizuara nga aktorë të tjerë”. Perceptimi i të anketuarve është që duhet bërë më shumë në këtë drejtim, sidomos për përmbushjen e rekomandimeve ku 36% e të anketuarve e gjykojnë “Kënaqshëm” dhe 48% me “Shumë mirë”.

Rikonfirmohet edhe këtë vit, rëndësia e angazhimit të institucioneve vendimmarrëse mbi pranimin e rekomandimeve dhe angazhimi serioz në mbi zbatimin e tyre.

Gjatë viteve 2023 – 2024 Sekretariati i KI ka ndërmarrë një sërë iniciativash avokuese duke marrë pjesë dhe dërguar komente e sugjerime në shumë platforma si: Raportimi në bisedimet dypalëshe Shqipëri-BE për shqyrtimin analitik (*screening*) të kapitullit “Bazat”, duke u konsideruar si model i suksesshëm dialogu dhe duke vlerësuar progresin e rekomandimeve; Dhënia e inputeve specifike për finalizimin e angazhimeve në Planin Kombëtar për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP); Avokimi për mbështetje të mundshme për sektorin privat brenda “Grupit të Financuesve të Projektit WBIF (*WBIF Project Financiers’ Group*)” në Bruksel; Prioritizimi i 59 rekomandimeve në Strategjinë e Specializimit Inteligent; Përcjellja e 23 rekomandimeve mbi Strategjinë për Decentralizimin dhe Vetëqeverisjen Lokale 2023-2030; Evidentimi i 34 rekomandimeve për t'u përfshirë në Programin e Reformës Ekonomike 2024-2026.


Figura 9. Avokimi i çështjeve të trajtuara në KI



3.9 Procesi i raportimit tek Anëtarët e KI

Nga indikatorët e kësaj kategorie, vlerësimi më i lartë i shkon publikimit të *Raporteve Vjetore të KI* nga 80% e anëtarëve. Ndërsa me 76% respektivisht vlerësohen publikimi i *buletinëve informues periodikë* dhe raportimi i *progresit të rekomandimeve*.

Figura 10. Raportimi tek Anëtarët e KI




04

Tre Pikat më të Forta të KI

1. Sikurse evidentuar në vitet e mëparshme, edhe këtë vit, pika më e fortë e KI është konsideruar nga 19% e të anketuarve *“Puna aktive e Sekretariatit, analizat dhe puna studimore e përcjellë përmes materialeve analitike”*.
2. Ndërsa 16% kanë gjykuar si shumë të rëndësishme *“Transparencën përmes materialeve të publikuara”*, indikator që në vitet paraardhëse ka qenë e renditur si e pesta për nga rëndësia.
3. Pika e tretë vijon të mbetet *“Mbështetja e BERZH si një faktor i rëndësishëm paanshmërie, reputacioni dhe serioziteti”* vlerësuar nga 15% e të anketuarve.

Figura 11. Tre pikat më të forta të KI




05

Përfshirja e Komunitetit të Biznesit dhe e Institucioneve Publike

Nën këtë komponent të intervistuarit shprehën pikëpamjet e tyre mbi cilësinë e përfshirjes së komunitetit të biznesit dhe mbi përfshirjen e institucioneve publike në KI.

Referuar komunitetit të biznesit, kategoria më e vlerësuar është konsideruar “Përbërja e anëtarësisë nga pikëpamja gjinore” nga 69% e anëtarëve. Ndërsa “Numri i përfaqësuesve në anëtarësinë e KI” dhe “Kontributi i shoqatave të biznesit në dialog”, kanë marrë vlerësim “Shumë mirë” nga 48% e të anketuarve.


Figura 12. Përfshirja e komunitetit të biznesit



Mbi cilësinë e përfshirjes së agjencive/institucioneve qeveritare në KI u konsideruan pesë indikatorë nga të anketuarit dhe ai që u vlerësua më pak, ishte “Shpejtësia e reagimit për përmbushjen e rekomandimeve”, përgjigje që është në linjë edhe me komentet në pyetjet e mësipërme ku theksohet angazhim më serioz i tyre në këtë drejtim.


Ndërsa, indikator i më i vlerësuar me “Shumë mirë” nga 68% e të anketuarve, është “Përbërja e anëtarëve dhe niveli i përfaqësimit”.

Figura 13. Përfshirja e institucioneve publike



06

Vizibiliteti i KI




Komponenti i vizibilitetit, nga viti në vit është zgjeruar me pyetje duke e parë si një kategori të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin mbi punën e KI, influencën e tij dhe bërjen transparente të materialeve të prodhuara e të diskutuara në këtë platformë.

Më konkretisht kategoritë e vlerësuara janë:

6.1 Niveli i njohjes së KI në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit

Mbi këtë pyetje, 56% e të anketuarve janë shprehur që KI njihet nga komuniteti i biznesit.

Figura 14. Niveli i njohjes së KI në nivel kombëtar nga komuniteti i biznesit




6.2 A mendoni se faqja e internetit e KI dhe publikimet në rrjetet sociale (FB/LI/ X) japin informacion të mjaftueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm?

80% e të anketuarve vlerësojnë që KI jep informacion të mjaftueshëm përmes rrjeteve sociale.

Komentet e dhëna nga të anketuarit mbi përmirësimin në këtë drejtim janë:

- Mund të konsiderohet prani më e madhe në botën e medias.
- Të vlerësohet mundësia e promovimit të koordinuar me shoqatat e sektorëve të biznesit

Figura 15. Niveli i informimit përmes rrjeteve sociale të KI




6.3 Informacionet më me interes për t'u lexuar online

Nga raporti i vitit 2022, evidentohen si dokumentat më me interes “Gjetjet e Vrojtimeve” (24%), “Notat Teknike” (19%), “Raportet e Monitorimit mbi Zbatimin e Rekomandimeve” (13%) dhe “Përmbledhjet e Treguesve Makroekonomikë” (13%).


Ndërsa këtë vit, informacione që konsiderohen me interes janë vlerësuar “Raportet e Monitorimit mbi Zbatimin e Rekomandimeve” (21%), “Gjetjet e Vrojtimeve” (20%) dhe “Notat Teknike” (19%).

Figura 16. Informacionet më me interes për t'u lexuar online



07


Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve



88% e të anketuarve vlerësojnë që KI ka ndikuar pozitivisht në klimën e investimeve në vend, duke cilësuar si fushat kryesore ku ka influencuar:

- (1) Në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj kërkesave të biznesit (20%)
- (2) Në përmirësimin e konsultimit (17%)
- (3) Nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj rekomandimeve të KI (14%)
- (4) Në rritje ndërgjegjësimi (14%)
- (5) Në përmirësimin e transparencës (12%)

Figura 17. Në çfarë drejtimi ka ndikuar KI në përmirësimin e dialogut?




7.2 Si mund të matet më mirë influenca e punës së KI ndër vite dhe kontributi në përmirësimin e klimës së investimeve?

Komentet më të rëndësishme në lidhje me këtë pyetje, kanë të bëjnë me:

- » Rritjen e promovimit të punës së KI dhe bërjen transparent të informacionit të akumuluar, sidomos realizimin e rekomandimeve si indikator kryesor dhe mundësisht arsyet pse nuk zbatohen.
- » Nevojë për analiza të detajuara të ndryshimeve rregullatore, akteve ligjore e nën ligjore dhe impaktit të tyre në sektorin privat.
- » Numrin e rekomandimeve që merren parasysh nga institucionet qeveritare.
- » Nevojën për fushata për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e klimës së investimeve.
- » Analizimin e ligjeve, proceseve të përmirësuara të konsultimeve publiko-private, të dhëna mbi investimeve e huaja, të dhëna mbi investimet e brendshme.
- » Dokumentimin e rasteve të suksesshme që tregojnë ndikimin pozitiv të Këshillit.

08

Eksperienca Personale dhe Profesionale me KI




8.1 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky angazhim?

Përfitimi më i madh nga pjesëmarrja në KI, konsiderohet “*Informimi*” nga 40% e të anketuarve, ndërsa 32% e të anketuarve vlerësojnë “*Avokimin publik*”.

Figura 18. Cili mendoni se ka qenë përfitimi juaj kryesor nga bashkëpunimi me KI?

Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky angazhim?

- Informimi
- Avokimi publik
- Ndarja e eksperiencave
- Rrjetëzimi




8.2 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin, cili ka qenë kontributi juaj kryesor?

Në raportin e vitit 2022, “*Kontributi në debate*” dhe “*Dërgimi i komenteve*” ishin përgjigjet e pjesës më të madhe të të anketuarve.

Ndërsa këtë vit, kryeson me 25% të vlerësimit nga anëtarët “*Ndërveprimi në aktivitete të përbashkëta*” duke reflektuar angazhimin e shtuar të Sekretariatit të KI në rritjen e ndërveprimit të vazhdueshëm jo vetëm me anëtarët por edhe ekspertë, institucione akademike e shoqëri civile.

Figura 19. Cili mendoni se ka qenë kontributi juaj kryesor në punën e KI?




09 Qëndrueshmëria e Platformës së KI

9.1 Opsionet e qëndrueshmërisë në afatgjatë të formatit të Këshillit të Investimeve dhe të Sekretariatit

96% e të intervistuarve e konsiderojnë Këshillin e Investimeve si *një platformë afatgjatë dialogu e me interes për biznesin, duke ofruar transparencë dhe balancim publik-privat*.

Mbi opsionet e qëndrueshmërisë së këtij formati në të ardhmen, evidentohet një barazi opinionesh mes vijimit me të njëjtin format dhe formatimit në institucion më vete nga respektivisht 44% e anëtarëve, ndërsa 8% shprehen në favor të pagesës së anëtarësimit në KI.

Figura 20. Qëndrueshmëria e KI si platformë afatgjatë



Një koment relevant është: *“KI duhet të ketë tagër juridik dhe detyrues për t’u marrë në konsideratë nga organizmat shtetërorë dhe politikëbërës. Pra, kur KI jep rekomandime, duhet që të jenë të detyrueshme për t’u ndjekur, zbatuar apo raportuar nga institucionet shtetërore.”*


10 Vijueshmëria e Bashkëpunimit me KI/Anëtarët e KI

Nga të gjithë të intervistuarit u shpreh gatishmëria e vijimit të bashkëpunimit dhe komunikimeve të vazhdueshme edhe përmes sugjerimeve të temave konkrete për t’u trajtuar, përfshirjes së KI në aktivitete të tyre dhe ndarjen e materialeve me KI.

Ju lutem për zgjidhni nga lista më poshtë, nëse jeni:

- Biznes
- Institucion Publik
- Dhomë Tregtie
- Shoqatë Biznesi

SHTOJCA 1. Pyetësi drejtuar anëtarëve e bashkëpunëtorëve të KI



Ju lutem përzgjidhni nga lista më poshtë, nëse jeni:

- a. Biznes
- b. Institucion Publik
- c. Dhomë Tregtie
- d. Shoqatë Biznesi
- e. Ekspert i lirë
- f. Institucion Edukues/Akademik
- g. Shoqëri Civile
- h. Përfaqësues i Medias
- i. Partner për zhvillim
- j. Donatorë/Programe zhvillimi
- k. Përfaqësi Diplomatike

1. Formati & Organizimi i KI si një kanal efektiv dialogu

1.1 *Si e vlerësoni formatin dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve?*
Ju lutem pikëzoni në një shkallë nga 1 në 5, secilin nga opsionet e mëposhtme:

☐ **Anëtarësia e KI (Numër, Përbërje, Proporcioni publik-privat)**

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4- Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

☐ **Si e vlerësoni Frekuencën e mbledhjeve të KI**

1-Duhet ulur 2- Kënaqshëm 3- Shumë Mirë 4 – Duhet përmirësuar 5 - Njësoj siç është aktualisht

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

☐ **Axhenda /Tematikat e trajtuara nga KI (Përzgjedhja e temave, Votimi nga anëtarët, Miratimi i agjendës vjetore)**

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4- Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

Metodologjia e punës

- A. Qasja nga poshtë-lart³
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- B. Konsultime aktesh ligjore, ligje e projektligje me palët e përfshira si biznes, qeveri, partnerë për zhvillim, ekspertë, shoqëri civile, akademikë, etj.
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- C. Përfshirja e anëtarëve në grupet e punës, në finalizimin e analizave dhe rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- D. Survejimet periodike
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- E. Koha e marrjes së njoftimeve dhe e dërgimit të materialeve për diskutim në mbledhjen e radhës së KI
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- F. Diskutimet teknike në fokus grupe përpara mbledhjeve të KI për validimin e gjetjeve dhe rekomandimeve
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- G. Diskutimet teknike nga anëtarët dhe të ftuarit gjatë mbledhjeve të KI.
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm
- H. Aspekti operacional i organizimit të mbledhjeve të KI (vendi, përkthimi, zhurmat, etj.)
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

3 Metoda e punës së KI i referohet marrjes së problematikave nga sektori privat, analizimi i tyre dhe trajtimi përmes gjetje e rekomandime në mbledhjet e KI.

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

☐ *Cilësia e materialeve analitike*

Qartësia/ Saktësia e të dhënave të paraqitura/ Gjatësia
1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar”, ju lutem komentoni

☐ *Prezantimi i materialeve analitike në mbledhjet e KI*

- A. A është e nevojshme të bëhet prezantimi i përmbledhjes së materialit analitik të përgatitur nga Sekretariati i KI, si bazë për mbështetjen e diskutimeve të strukturuar më pas, mes sektorit privat dhe atij publik?
- ☐ Po
- ☐ Jo
- B. Nëse u përgjigjet Po në pyetjen e mësipërme, a mendoni se kjo përmbledhëse
- a. Duhet diskutuar më gjatë sesa realisht bëhet (rreth 10 min)
 - b. Duhet të jete më e shkurtër
 - c. Duhet të jetë më e qartë
 - d. Duhet të jetë me e detajuar
 - e. Duhet të jetë më pak e detajuar
 - f. Tjetër

Nëse u përgjigjet Tjetër, më sipër ju lutem komentoni

□ Rekomandimet

A. Cilësia

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

B. Përshtatshmëria

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

C. Koherenca

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

D. Llogaridhënia & Publikimi

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Avokimi i çështjeve të trajtuara /Ndjekja e diskutimeve

A. Nxitja e përmirësimit të rekomandimeve me aktorë me influencë

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

B. Trajtimi i problematikave të trajtuara në KI edhe në takime të organizuara nga aktorë të tjerë (bashkëpunim)

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Procesi i raportimit tek Anëtarët e KI

A. Përzgjedhja dhe njoftimi mbi ndryshimet në anëtarësi apo informacione të tjera organizative

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

B. Raportimi i progresit të rekomandimeve

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

C. Raporte vjetore

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

D. Buletinë informues periodikë

1-Duhet përmirësuar 2- Mirë 3- Kënaqshëm 4 - Shumë mirë 5- Shkëlqyeshëm

Nëse u përgjigjet “Duhet përmirësuar” në ndonjërin nga pikat, ju lutem komentoni

□ Në këndvështrimin tuaj, ju lutem listoni (qarkoni) 3 pikat më të forta të KI:

- A. Tematikat e trajtuara në KI
- B. Metodologjia e votimit të temave nga anëtarët
- C. Metodologjia e punës, ndjekja e çështjeve dhe insistimi në realizimin e objektivit
- D. Vëmendja e aktorëve kryesorë të qeverisë përmes pranisë së përhershme të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- E. Gjithëpërfshirja, angazhimi dhe tërheqja e vëmendjes së përfaqësuesve kryesorë të qeverisë, bizneseve e donatorëve
- F. Puna aktive e Sekretariatit, analiza dhe puna studimore e përcjellë përmes materialeve të çdo mbledhjeje
- G. Rekomandimet e aprovuara në KI
- H. Ndjekja sistematike e progresit të rekomandimeve
- I. Ndermjetësimi me aktorët përgjegjës për të përshpejtuar përmirësimin e rekomandimeve
- J. Mbështetja e BERZH si një faktor i rëndësishëm paanshmërie, reputacional dhe serioziteti
- K. Balancimi i duhur i përfaqësimit qeveri-biznes
- L. Transparenca përmes publikimit të të gjithë materialeve të prodhuara
- M. Tjetër

4. Ndikimi i KI në Klimën e Investimeve

4.1 A ka ndikuar KI në përmirësimin e dialogut për klimën e investimeve në Shqipëri? PO JO

Nëse po, konkretisht në çfarë drejtimi:

- a) në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj kërkesave të biznesit
- b) në nxitjen e institucioneve publike për reagim ndaj rekomandimeve të dhëna në KI
- c) në nivel politikash
- d) në kuadrin rregullator
- e) në kuadrin ligjor
- f) në përmirësimin e konsultimit
- g) në rritje ndërgjegjësimi
- h) në ndërhyrje fiskale
- i) në përmirësimin e transparencës

4.1 Në opinionin tuaj, sugjeroni si mund të matet më mirë influenca e punës së KI ndër vite dhe kontributi në përmirësimin e klimës së investimeve? (P.sh. transparencë, konsultimi, ndërgjegjësimi, etj.)

1. _____
2. _____

5. Eksperienca personale dhe profesionale me KI

5.1 Gjatë eksperiencës suaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky angazhim?

- A. Informimin
- B. Advokimin publik
- C. Rrjetëzimin
- D. Ndarja e eksperiencave

5.1 Cili ka qënë inputi juaj kryesor në bashkëpunim me KI?

- A. Dërgim komentesh
- B. Plotësim ankete

- C. Shpërndarje e anketave për plotësim nga të tretë
- D. Kontribut në debate
- E. Ndërveprim në aktivitete të përbashkëta
- F. Advokim i punës së KI tek të tretë

6. Qëndrueshmëria e platformës së KI

- ☐ A e shikoni Këshillin e Investimeve si një platformë afatgjatë dialogu dhe me interes për biznesin? PO JO




Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Komente nga anëtarë e bashkëpunëtorë të Këshillit të Investimeve

SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE



2024



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).